



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 15.6.2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar i Komisionit, Fadil Demaku-nënkryetar i parë, Qerim Bajrami, Zafir Berisha, Rexhep Selimi dhe Nuredin Ibishi -anëtarë.

Munguan: Bojan Mitiq dhe Ganimete Musliu.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Përfaqësuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme- Mergim Himaj - u.d. i udhëheqësit i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit-DL; Shpresa Shllaku – Zyrtare e Lartë Ligjore-DL; Bekim Hoxha – Udhëheqës i Drejtorisë për Prodhimin e Dokumenteve-ARC; Musa Thaçi - Udhëheqës i Drejtorisë për Pajisje me Dokumente-AR.

Pjesëmarrës të tjerë: Donika Emini -QKSS, Përparim Kryeziu- QKSS, Jeton Bytyçi- OSBE dhe Arbanë Pireva, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së Komisionit të mbajtura më 18.05.2015 dhe 27.05.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 18.05.2015 dhe 27.05.2015

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim

Kryetari i Komisionit- Theksoi se sipas procedurave lexojmë projektligjin nga titulli dhe më pas vazhdojmë nen për nen. Gjithashtu njoftoi se nga ana e deputetit Nait Hasani janë propozuar dy amendamente për këtë projektligj.

Rexhep Selimi- Lidhur me projektligjin theksoi se duhet të kemi vëmendjen dhe kujdesin, pasi në të kaluarën ka pasur problematika në të kaluarën në procesin e prodhimit të dokumenteve dhe për këtë arsye duhet të kemi vëmendjen gjatë shqyrtimit të këtij projektligji.

Bekim Hoxha, udhëheqës i Drejtorisë për Prodhimin e Dokumenteve-ARC- Theksoi se departamenti që drejton është mjaft i sofistikuar dhe se nuk ka probleme dhe se prodhimi i dokumenteve është duke shkuar në mënyrë të sigurt. Ndërsa sa i përket shpërndarjes së informatave se ka probleme, theksoi se nuk është e vërtetë.

Kryetari i Komisionit- Filloi leximin e projektligjit. Më tutje pas debatit u propozua që në nenin 2, paragrafin 1, nënparagrafi 1.5 të riformulohet. Gjithashtu u propozua që fjala “mesazhe” të zëvendësohet me “porosi”. Gjithashtu u propozua që fjala “të gjitha” të fshihet nga teksti i projektligjit. Tutje gjatë leximit të nenit 8 theksoi se nga ana e z. Nait Hasani janë propozuar dy amendamente dhe njëra nga to ka të bëjë me nenin tetë. Amendamenti i tij është “Neni 8 riformulohet si vijon: Forma dhe mënyra e punimit të letërnjoftimit përcaktohet me ligj”.

Rexhep Selimi- Theksoi se e mbështet shqetësimin e z. Nait Hasani, i cili është shprehur përmes propozim-amendamentit, por konsideroi që nuk është e mundur që të bëhet një ligj i tillë pasi mbulon një çështje të vogël dhe nuk mund të mbulohet me ligj pasi mund të ketë ndryshime.

Kryetari i Komisionit- Pas debatit lidhur me nenin 8 të këtij projektligji, me propozimin e z. Zafir Berishës dhe të Qerim Bajramit, Rexhep Selimit e Nuriedin Ibishit neni 8 riformulohet: “Forma dhe mënyra e punimit të letërnjoftimit përcaktohet me akt nënligjor nga Qeveria.

Qerim Bajrami- Shtoi se te neni 10 i projektligjit ka një propozim, të shtohet një paragrafi i ri në ligj, kurse te paragrafi 2 të futet për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, letërnjoftimet të shtypen edhe në gjuhët e tyre që janë në përdorim në nivelin lokal, pasi ligji për përdorimin e gjuhëve nuk e përcakton këtë sepse është miratuar shumë më herët. Më shumë se një vit në kemi letërnjoftim edhe në gjuhën turke, kurse më shumë se një vit e kemi propozimin nga bordi për gjuhë që e njëjta gjë të vlejë edhe për komunitetin boshnjak të Kosovës.

Bekim Hoxha - Ne kemi filluar të lëshojmë letërnjoftim edhe në gjuhën turke, momentalisht jemi duke lëshuar letërnjoftime në gjuhët zyrtare që janë në nivelin qendror shqip, serbisht edhe turqisht. Kërkesa e z. Bajrami për momentin është e pamundur se krijon kosto për implementimin e këtij propozimi por, për gjuhën turke është bërë me kërkesë të Kryeministrit z. Thaçi në vitin 2013.

Qerim Bajrami- Gjuha turke në Kushtetutë edhe në ligje të tjera janë të barabarta, në Prizren edhe sikur komuniteti turk të jetë një për qind, gjuha turke përsëri do të jetë gjuhë zyrtare, ky është kuptimi i këtij paragrafi të ligji për gjuhët.

Jeton Bytyçi, OSBE- Kemi propozuar që formularët për letërnjoftim të plotësohen në gjuhët zyrtare dhe në gjuhën që janë në përdorim zyrtar. Kurse sa i përket shtypjes së letërnjoftimeve edhe në gjuhën boshnjake kjo kompetencë i përket nivelit qendror.

Rexhep Selimi- Ligji për gjuhët është ligji më i pa drejt që ka ardhur deri tash, sepse ky ligj për gjuhët shkel të drejtat e dy komuniteteve, e para shkel të drejtat e shumicës ku barazohet gjuha serbe me një gjuhë të shumicës dhe diferencohet me gjuhët e pakicave të tjera duke qenë i njëjti komunitet pakicë, inkurajoj z. Qerimi dhe do e mbështesë në çdo nismë si deputet nëse ky nis çfarëdo plotësim-ndryshimi për ligjin për gjuhët.

Musa Thaçi - Ligji për gjuhët, pjesa e dytë e paragrafit 2.3 e nenit 2 thotë se pavarësisht kësaj që u tha më lart në mënyrë të veçantë në Komunën e Prizrenit, gjuha turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare. Edhe në Kushtetutë në nenin 5, paragrafi 2 ceket që gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune. Në ligjin për gjuhët është bërë një gabim ku thotë se gjuha turke ka statusin e gjuhës zyrtare.

Kryetari i Komisionit- Këtë pikë nuk do e votojmë sot. neni 10 do jetë në pritje deri sa të dorëzohen me shkrim amendamentet e z. Qerimi. Te kapitulli 3 (tre) i projektligjit, vlefshmëria e letërnjoftimit, neni 11, afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit, jemi të gjithë dakord që afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit mbi moshën 26 vjeçare të jetë 10 (dhjetë) vjet, kurse për personat prej 16 deri 26 vjeç vlefshmëria e letërnjoftimit të jetë deri në 5 (pesë) vjet.

Donika Emini QKSS- Të përshkallëzohet mosha për letërnjoftime në projektligji që të jetë më e qartë për qytetarët.

Bekim Hoxha- Të gjithë personat mbi 26 vjet kanë 10 vjet afat të letërnjoftimit, arsyeja pse është 10 vjet është se certifikata që vendoset ka afatin e skadencës 10 vjet dhe ky është cikli që e mbyll komunikimin e të dhënave elektronike.

Donika Emini, QKSS- Po kthehem prapë te neni 3, a e keni konsideruar mundësinë për persona 14 vjeç që ta kenë të drejtën të posedojnë letërnjoftime, jo obligueshmërinë por të drejtën.

Bekim Hoxha- Ky problem zgjidhet me pasaportë.

Rexhep Selimi- Në shtetet që kemi marrëveshje që kufiri të kalohet vetëm me letërnjoftime, si është e definuar kjo marrëveshje për fëmijët? A është pjesë e secilës marrëveshje që fëmijët nën moshën 16 vjeç të kalohet kufiri vetëm me certifikatë të lindjes ?

Musa Thaqi- Më certifikatë të lindjes pa problem e kalon kufirin në shtetet ku kemi marrëveshje, por në raste kur fëmija kalon kufirin vetëm me njërin prind duhet patjetër të ketë edhe autorizimin e prindit tjetër.

Kryetari i Komisionit- Kalojmë te neni 12 pavlefshmëria e letërnjoftimit, pika 1.3 kemi nevojë për një sqarim më të saktë.

Bekim Hoxha- Këtu kemi të bëjmë me ndërrimin e të dhënave nga personi, siç mund të jetë martesë, ku mund të ndërrohet mbiemri ose në rastet kur ndërrohet edhe vendbanimin.

Kryetari i Komisionit- Në të gjitha rastet ku në projektligji është fjala “ministria” zëvendësohet me fjalët “organi kompetent”, pasi që kështu u pajtuam në fillim. Në nenin 22 paragrafi 2, shtohet pike e re 2.3 me tekstin si në vijim “Nëse personi nuk dëshiron ta jap për identifikim sipas paragrafit 1 të nenit 4 të këtij ligji”.

Zafir Berisha- Duhet të gjendet një modus te pika 2.2 e nenit 22 ku thotë se të dënohet me gjobë deri në 20 euro personi i cili nuk e posedon me vete letërnjoftimin, sipas kësaj sikur po i jepet një e drejtë policit të ndalojë secilin person kur e sheh nga veshja që ai/ajo mundet të mos ketë dokument, ku ndoshta ai /ajo ka dalë për një obligim të shpejtë dhe nuk ka marrë asgjë më vete.

Rexhep Selimi- Propozoj që te kjo pikë që e përmendi z. Berisha të riformulohet si vijon “ dënohet me gjobë prej 20 (njëzet deri në 100 (njëqind) euro personi i cili nuk posedon me vete letërnjoftim ose dokument tjetër të vlefshëm”

Përparim Kryeziu QKSS- Sa i përket rasteve kur lirohesh prej akuzës për mos posedim të letërnjoftimit, në cilat raste mund ta përdorësh patentë shoferin ose pasaportën, si dokument identifikues?

Musa Thaqi- Obligim me këtë ligj është që secili qytetar i Republikës së Kosovës të posedojë letërnjoftimin. Letërnjoftimi është i vetmi dokument identifikues, nëse një qytetar i Kosovës nuk e posedon letërnjoftimin atëherë është sanksioni.

Fadil Demaku- Mendoj që kjo pikë nuk duhet të ndryshohet, nëse ne i heqim përgjegjësinë qytetarit të Republikës së Kosovës për mos posedimin e dokumentit identifikues, siç është letërnjoftimi atëherë përse bëhet?

Kryetari i Komisionit- Problemi te neni 22 qëndron vetëm te masat ndëshkuese. Te neni 23, të gjitha të hyrat që realizohen me zbatimin e këtij ligji derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës. Në të kaluarën ka qenë një përqindje që derdhej në buxhetin e komunës. Tani këto të hyra janë bartur komplet në nivel qendror, më përkrahjen e deputetëve të tjerë nuk ndryshohet ky nen.

Rexhep Selimi- Ngarkojmë administratën për harmonizimin e pikës 2 të nenit 24 me pikën përkatëse të nenit 8.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit i informoj deputetët për vizitën studimore në Zagreb, Kroaci më 5-8 korrik 2015. Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj